



Si duhet të Parakualifikohem si Ofertues i Regjistruar?

Në Zyrën Qendrore të AKP-së në Prishtinë, Njësinë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitor, SË PAKU 5 DITË DITË PUNE para ditës për dorëzimin e ofertave ju duhet të dorëzoni dokumentet në vijim (*shembujt e formave të kërkuara i janë bashkangjitur këtij udhëzuesi*):

1. Informatat e juaja për kontakt.

Kjo është një letër ku janë të shkruar:

- Emri juaj
- Adresa (*Te gjitha adresat e juaja gjate vitit*)
- Qyteti dhe Shteti ku jetoni
- Numri juaj i telefonit/mobilit/faksit
- Adresa e emailit tuaj
- Të dhënat e mësipërme në lidhje me ndonjë përfaqësues.

2. Deklarata e kualifikueshmërisë

Kjo është një letër që do të shkruhet nga ju. Aty ju konfirmoni dhe pohoni se nuk jeni ofertues me ndalesë ofertimi, siç është përshkruar me nenin 4 të Rregullave të Tenderit. (shiko paragrafin 4.1 të Rregullave të Tenderit për listën e plotë të ofertuesve me ndalesë ofertimi)

3. Nëse ju paraqitni ofertë si individ, duhet të dorëzohet **kopja e lejës suaj të njoftimit /pasaportës** tuaj si dhe **certifikata** e cila tregon se ju nuk jeni nen hetime.

4. Nëse paraqitni ofertën si subjekt juridik/ortakëri/konzorcium, duhet të dorëzoni **kopjen e regjistrimit të biznesit tuaj/kopje të dokumenteve themeluese**, përfshirë **të dhënat mbi identitetin** e pronarëve përfitues dhe personave kontrollues si dhe **certifikatat** të cilat tregojnë se pronari/bashkëpronarët/partnerët nuk janë nën hetime (*shiko nenin 7.2 të Rregullave të Tenderit*).

5. Autorizimi

Nëse ju jeni përfaqësues i ndonjë entiteti, ju duhet të identifikoni atë entitet. Gjithashtu, ju duhet të siguroni të gjitha dokumentet e listuara më lartë, përfshirë deklaratën e kualifikueshmërisë, kopjen e lejës suaj të njoftimit /pasaportës tuaj si dhe certifikata e cila tregon se ju nuk jeni nen hetime.

*Kërkesa për regjistrim si ofertues i kualifikuar dhe dëshmitë e bashkëngjitura, shqyrtohen nga komisioni vlerësues.

**Agjencia do t'ua lëshojë certifikatën për regjistrimin e kualifikueshmërisë, e cila përmban edhe numrin e regjistrimit të kualifikueshmërisë, vetëm nëse vendimi i komisionit vlerësues është pozitiv.

***Ky dokument shërben vetëm si udhëzues dhe nuk zëvendëson kërkesat e cekura në Rregullat e Tenderit. Kërkesa për regjistrim duhet të bëhet në përputhje me Rregullat e Tenderit të zbatueshme

Informatat e Kontaktimit

Emri Mbiemri:

Adresa:

Vendi:

Tel:

E-mail:

Nënshkrimi: _____

Me këtë nënshkrim dëshmoj se të dhënat e mia janë të sakta dhe pajtohem se këto të dhëna të kontaktit mund të përdoren nga AKP-ja edhe për qëllime të marketingut direkt, përfshirë njoftimet për shpalljet e shitjeve në të ardhmen dhe të ngjajshme.

Data:

Deklarata e Kualifikueshmërisë

Nëpërmjet kësaj deklarate unë pohoj se i kam lexuar dhe kuptuar Rregullat e Tenderit dhe garantoj se i plotësoj kushtet e cekura në Rregullat e Tenderit, përfshirë seksionin 4.1.

Emri Mbiemri: _____

Nr. Personal: _____

Nënshkrimi: _____

Data:

Informatat e Kontaktit për Ndërmarrje

Emri i Ndërmarrjes:

Pronari/ët:

Përfaqësuesi:

Adresa:

Vendi:

Tel:

E-mail:

Nënshkrimi: _____

Me këtë nënshkrim dëshmoj se të dhënat e mia janë të sakta dhe pajtohem se këto të dhëna të kontaktit mund të përdoren nga AKP-ja edhe për qëllime të marketingut direkt, përfshirë njoftimet për shpalljet e shitjeve në të ardhmen dhe të ngjajshme.

Vula:

Data:

Deklarata e Kualifikueshmërisë

Unë, pronari/përfaqësuesi i Ndërmarrjes “_____”, nëpërmjet të kësaj deklaratë pohoj se i kam lexuar dhe kuptuar Rregullat e Tenderit dhe garantoj se i plotësoj kushtet e cekura në Rregullat e Tenderit, përfshirë seksionin 4.1.

Emri Mbiemri: _____

Nr. Personal: _____

Nënshkrimi: _____

Vula:

Data: